



V E N D I M

K.P.P. 665/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Ersi/M” sh.p.k, në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-76056-06-22-2018, me objekt: “Supervizioni i punimeve për objektin: “Ndërtim Stacionesh pompimi dhe Deposh në Ujësjellësa Rajonal, Faza II”, Loti 3, me fond limit 877.443 (tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime sh.a Tiranë.”

Ankimues:

“Ersi/M” sh.p.k
Blv “Dervish Hekali”, Ballsh

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjellës Kanalizime sh.a Tiranë
Rruga “5 Maj”, pranë Medresesë Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatoriët e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.06.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-76056-06-22-2018, me objekt: “Supervizioni i punimeve për objektin: “Ndërtim Stacionesh pompimi dhe Deposh në Ujësjellësa Rajonal, Faza II”, Loti 3, me fond limit 877.443 (tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime sh.a Tiranë.

II.2. Në datën 10.07.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Ersi/M” sh.p.k	745.827,00 lekë, skualifikuar
2. “C.E.C Group” sh.p.k	795.000,00 lekë, skualifikuar
3. “Derbi-E” sh.p.k	798.000,00 lekë, skualifikuar
4. “Infratech” sh.p.k	814.280,00 lekë, kualifikuar
5. “Tower” sh.p.k	814.280,00 lekë, skualifikuar
6. “He&Sk 11 11” sh.p.k	826.752,00 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Ersi/M” sh.p.k është njoftuar elektronikisht nga KVO-ja për arsyet e skualifikimit të tij si më poshtë vijon:

“Së pari ak në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik “ERSI-M” shpk, konstatoi se, Operatori Ekonomik “ERSI-M” shpk nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pasi Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur nga Operatori Ekonomik është nën vlerën minimale të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor Mbeshtetur në VKM nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe në mbështetje të udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publik datë 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016” Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Operatori ekonomik do të skualifikohet nëse ofertat e tyre do të rezultojnë nën minimumin e lejuar të përlllogaritur nga AK (në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016, në varesi të kategorisë dhe grupit tarifor ku bën pjesë objekti i prokurimit). Oferta e Operatorit Ekonomik “ERSI-M” shpk, rezulton nën minimumin e lejuar të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016. Bazuar në Rekomandimin e APP-së nr.5585 datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”, pika 2 shprehimisht thuhet se : “Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat mund të jenë më të ulta sesa normat minimale, të specifikuara nga ky manual”. Në rastin kur Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanën e jashtëzakonshme, Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertës duhet ti referohet vlerës minimale të përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi në bazë të parashikimit në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”. Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nëse ndodhet në rrethana të jashtëzakonshme për procedurën e prokurimit me objekt: Loti i tretë: ““Supervizioni i punimeve për objektin: “Ndërtim Stacionesh pompimi dhe Deposh në Ujësjellës Rajonal, Faza II”, Loti 3, me fond limit 877.443 (tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “ERSI-M” shpk, është i paplotë pasi nuk ka përmbushur VKM nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik datë 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016” Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Operatori ekonomik do të

skualifikohet nese ofertat e tyre do te rezultojne nen minimumin e lejuar te perlllogaritur nga AK (ne baze te VKM nr.354, date 11.05.2016, ne varesi te kategorise dhe grupit tarifar ku ben pjese objekti i prokurimit).Komisioni i Vleresimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje VKM nr.354 date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim" si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 "Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016" Per miratimine manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim". , e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e sa më sipër.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.1.b si më poshtë cituar: b. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, operatori ekonomik "ERSI-M" "ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi: "Vërtetim debie" nr. 3264 prot, date 11.06.2018 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit "ERSI-M" ku evidentohet që: "... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 11.06.2018 pa përfshirë faturën koherente të muajit Maj 2018. Referuar Nenit 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë", përcaktohet shprehimisht që: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Maj 2018.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vleresimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma "d" të vendosur në DST, c'ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma "c" ku ndër të tjera citohet se "Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë." Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të APP-së është bërë në datën 28.03.2018 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 23.04.2018 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit Maj si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë", përcaktohet shprehimisht që: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në

faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë”. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

II.3. Në datën 16.07.2018 operatori ekonomik “Ersi/M” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij, në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“Në lidhje me arsyen e skualifikimit të ngritur nga ana juaj duke na klasifikuar si ofertë që rezulton nën minimumin e lejuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka detyrimin ligjor që para se të bëjë klasifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës duhet të kërkojë sqarime nga ata. Sic edhe e parashikon LPP dhe përcaktuar nga ana juaj në dokumentat e tenderit, në pikën 3.4.2, paragrafi 4 thuhet se: “Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së.

Ju këtë pikë nuk e keni repektuar, pasi ne si operator ekonomik pjesëmarrës nuk kemi marrë asnjë njoftin nga ana juaj për argumentimin e ofertës së dhënë dhe në këto rrethana vlerësimi juaj bëhet nul. Ligji i prokurimit publik, i ndryshuar parashikon në nenin 55: “Oferta fituese duhet të jetë oferta ekonomiksht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet si: cilësia, cmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jo diskriminuese”. Shoqëria jona ka dhënë ofertën më të favorshme ekonomike dhe bashkëlidhur do të gjeni dhe zbërthimin analitik të saj (të cilin duhet ta kishit kërkuar ju para fazës së vlerësimit të ofertave).”

Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit, ankimesi argumenton se:

“Procedura e prokurimit është zhvilluar me datë 05.07.2018. Shoqëria jonë ka paraqitur në tender vërtetim debie nr. 3264 prot., datë 11.06.2018 “...nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit, për kontratat me rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 11.06.2018, pa përfshirë faturën koherente të muajit maj 2018”. Duam tju bëjmëme dije se me datë 05.07.2018 shoqëria jonë nuk rezulton me detyrime në lidhje me pagesën e faturave të energjisë elektrike dhe për këtë do tju vëmë në dispozicion mandat pagesën

e kryer. Mospapaqitja e pagesës së kryer të energjisë elektrike për muajin Mj 2018, në vërtetim vjen si rezultat i burokracive të krijuara nga zyrat e OSHEE-së.”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. K-3092/1 prot., datë 16.07.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.5. Në datën 23.07.2018 operatori ekonomik “Ersi/M” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 31.07.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1296/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. K-3240/1 prot., datë 30.07.2018, me objekt: *“Informacion i hollësishëm mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: Supervizioni i projekteve për rrjetin e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve Faza II”, të ndarë në lote si më poshtë vijon: Loti i Parë: “Supervizioni i punimeve për objektin: “Ndërtim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime në zonën e Lanabregasit, Faza II”, Loti i tretë: “Supervizion i punimeve për objektin: “Ndërtim stacionesh pompimi dhe deposh në ujësjellësa rajonal, Faza II”, Loti i katërt: “Supervizioni i punimeve për objektin: “Ndërtim impianti klorinimi dhe rikonstruksion deposh Qytetet”, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Ersi/M” sh.p.k se: *“[...]Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1 Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1 gërma “b” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

- *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektornike operatori ekonomik “Ersi/M” sh.p.k, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si vijon:

- *Vërtetim Debie me nr. 2264 prot., datë 11.06.2018 lëshuar nga OSHEE me anë të së cilës vërtetohet se: Kërkuesi “Ersi/M” sh.p.k nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit*

për kontratën/kontratat (me kod) [...] rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 11.06.2018, pa përfshirë faturën koherente të muajit Maj 2018.

III.1.3. Në Nenin 27, pika 5, gërma “c” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet që: *[...]Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: ç) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”*

III.1.4. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*

III.1.5.Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 15.06.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1081/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, për dijeni Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë: 7 *“[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkuar të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:*

- 1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).*
- 2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.*
- 3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.*

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimt bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qendrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

- 1.Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.*

2.Konsumatori rezulton debitor.

3.Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këtë.

4.Konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.

5.Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]

Gjithashtu referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 30.03.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 6287/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, në të cilin dorëzohet një kopje e formatit standard të lëshimit të vërtetimit të debisë nga ku rezulton se është si më poshtë vijon: “[...] Bazuar në deklarinë e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) z._____ vërtetojmë se kërkuesi_____ nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën/kontratën (me kod) _____, titular i së cilës/cilavë është_____ rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e përlllogaritur deri në datën _____._____._____ pa përfshirë faturën koherente të muajit _____ [....]

III.1.6. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa neni 53, pika 3 përcakton: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përmes dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Ersi/M” sh.p.k nuk vërteton se ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike përfshirë muajin Maj 2018. Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit 05.07.2017 dhe Nenit 9, paragrafi 1 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, operatori ekonomik “Ersi/M” sh.p.k nuk ka përmbushur e detyrimet ligjore për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike pasi në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, detyrimet e energjisë elektrike për muajin Maj 2018 janë maturuar. Sa më sipër, K.P.P gjykon se Operatori ekonomik “Ersi/M” sh.p.k nuk përmbush pikën 1, gërmën “b” të Shtojcës 7, kriteret e veçanta të kualifikimit, pra nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për konfirmimin nga ana e OSHEE-së mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik “Ersi/M” sh.p.k, që është i regjistruar në Shqipëri.

Pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

III.2. . Lidhur me pretendimet mbi arsyen tjetër të skualifikimit të operatorit ekonomik “Ersi/M” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar arsyetimit të dhënë më sipër në pikën III.1, gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të pranimit/kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike edhe pas arsyetimit të KPP mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk do të ndryshojë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ersi/M” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-76056-06-22-2018, me objekt: “*Supervizioni i punimeve për objektin: “Ndërtim Stacionesh pompimi dhe Deposha në Ujësjellësa Rajonal, Faza II”*”, Loti 3, me fond limit 877.443 (tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH pa tvsh, zhvilluar në datën 05.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime sh.a Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1298 Protokolli,

Datë 23.07.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha